

GJL nr.1225/2012


GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Shkelzen Maliqi nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.18235/12, datë 27.07.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 31.10.2012 merr

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.



Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.18235/12, të datës 27.02.2012, të pandehurin Shkelzen Maliqi nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse si zyrtar i lartë publik, Këshilltar Politik në Ministri të Punëve të Jashtme, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjor 31 mars 2012, në Agjencionin Kundër Korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhje dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 2000.-€ (Dymijë euro), duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se kundërvajtja e cila i veht në barë nuk mund të cilësohet si mos deklarim i pasurisë sepse ky pasurinë e ka deklaruar edhe pse me vonesë, se gjoba që i është shqiptuar është shumë e lartë në krahasim me pagën që e merr si Këshilltar Politik MPJ pra thekson se kjo gjobë nuk është adekuate as me peshën e kundërvajtjes andaj konsideron se gjoba e tillë duhet të rivlerësohet.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 25.07.2012 në të cilën thekson se nuk ka qenë në dijeni për deklarin e pasurisë brenda afatit ligjor 31. mars 2011 ? dhe se nuk ka qenë i njoftuar nga pika kontaktuese e cila ka qenë e obliguar që ta informo dhe rrjedhimisht nuk e ka deklaruar pasurinë në afatin ligjor, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të:

-vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

